



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-020
Prishtinë, më 7 qershor 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 7 QERSHOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca
Enis Kervan dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 maj 2011,
2. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Glauk Konjufca, për takim të Kryesisë së Kuvendit me veteranët grevistë të UÇK-së,
3. Kërkesa e Komisionit Kushtetues për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në Kroaci,
4. Kërkesa për lejimin e vizitës zyrtare të dy nënkryetarëve të Kuvendit në Norvegji,
5. Kërkesa e Komisionit për Arsim, Administratë Publike dhe Media për lejimin e vizitës zyrtare në Shqipëri,
6. Kërkesa e një grupi të deputetëve për lejimin e vizitës zyrtare në Komisionin Evropian, në Belgjikë,
7. Kërkesa e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës për ndihmë financiare, për realizimin e Projektit – Zhdukja e Analfabetizmit,
8. Kërkesa e Komisionit përzgjedhës të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, për kompensim,
9. Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, lidhur me vizitën e realizuar në Bruksel.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 maj 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 maj 2011.

2. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Glauk Konjufca, për takim të Kryesisë së Kuvendit me veteranët grevistë të UÇK-së

Nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, i njoftoi anëtarët e Kryesisë me shqetësimet e veteranëve të UÇK-së, që janë hedhur në grevë para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Shqetësimet e tyre, shtoi z. Konjufca, janë pse po vonohet procedimi dhe miratimi i Ligjit për vlerat e UÇK-së, si dhe rregullimi i statusit të veteranëve.

Kryetari i Kuvendi, Jakup Krasniqi, tha se Projektligji për vlerat e UÇK-së, që rregullon edhe statusin e veteranëve, së shpejti do të procedohet prej Qeverisë në Kuvend, për shqyrtim dhe miratim.

Kryesia konstatoi se duhet të organizohet një takim me përfaqësuesit e veteranëve, që janë hedhur në grevë, për t'ju shpjeguar se Projektligji që rregullon statusin e tyre, së shpejti do të procedohet në Kuvend dhe nuk kanë arsye që të vazhdojnë grevën për këtë çështje.

3. Kërkesa e Komisionit Kushtetues për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në Kroaci

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, konstatoi se duhet bërë konsultime për arsyeshmërinë e realizimit të kësaj vizite dhe në bazë të saj, kryetari i Kuvendit të vendos për këtë çështje.

4. Kërkesa për lejimin e vizitës zyrtare të dy nënkryetarëve të Kuvendit në Norvegji

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, vendosi që Kuvendi të përfaqësohet me tre anëtarë të përhershëm në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, në këtë përbërje: një përfaqësues nga pozita, një përfaqësues nga opozita dhe një përfaqësues nga komunitetet.

Kërkohet nga Grupi Parlamentar i LDK-së, si partia më e madhe në opozitë, që ta caktojë përfaqësuesin e vet në këtë delegacion, pasi që pozita kishte caktuar z. Xhavit Haliti, dhe komunitetet kishin caktuar z. Petar Miletiq, që të jenë përfaqësues të përhershëm të Kuvendit, të kësaj legjislature, në takimet që kanë të bëjnë me NATO-n.

5. Kërkesa e Komisionit për Arsim, Administratë Publike dhe Media për lejimin e vizitës zyrtare në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, gjegjësisht i grupit punues për amendamentimin e Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal, prej 5 deri më 7 qershor 2011, në këtë përbërje: Idriz Vehapi, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqu, Teuta Haxhiu, Vesimir Saviq, si dhe Drita Morina dhe Mirjeta Heta, staf mbështetës i Komisionit.

2. Shpenzimet e qëndrimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i bartë organizatori, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjeve do të përballohen nga buxheti i Kuvendit.

6. Kërkesa e një Grupi të deputetëve për lejimin e vizitës zyrtare në Komisionin Evropian, në Belgjikë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i një Grupi të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Bruksel, prej 26 deri më 30 qershor 2011, në këtë përbërje: Teuta Sahatqija, Rita Hajzeraj-Beqaj, Vjosa Osmani, Arben Gashi, Visar Ymeri, Alma Lama, Liburn Aliu, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Burim Ramadani, Time Kadrijaj dhe Ardian Gjini, si dhe Ariana Musliu, nga Administrata e Kuvendit.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për deputetët e lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi, do t'i mbulojë Komisioni Evropian, ndërsa, mëditjet shtesë për deputetët dhe të gjitha shpenzimet për zyrtaren Ariana Musliu përballohen nga buxheti i Kuvendit.

7. Kërkesa e Komitetit të Grave të Verbëra të Kosovës për ndihmë financiare, për realizimin e Projektit “Zhdukja e analfabetizmit”

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet ndihma financiare Komitetit të Grave të Verbëra të Kosovës, në shumën prej 1.000 euro, për realizimin e Projektit: “Zhdukja e analfabetizmit”.

8. Kërkesa e Komisioni përzgjedhës të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, për kompensim

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik: Shukri Sylejmani, Nehat Idrizi dhe Rasim Rasimi.

2. Kompensimi për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi, është në shumën prej 50 euro për një mbledhje.

9. Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, lidhur me vizitën e realizuar në Bruksel

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, të realizuar në Bruksel, nga data 9 deri më 11 maj 2011.

Në fund, Kryesia konstatoi se Kuvendi duhet t'i caktojë delegacionet e përhershme që e përfaqësojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe në organizatat rajonale.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.